Në bazë të nenit 158-s paragrafi 1 nga Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 88/05, 79/07, 08/08, 88/08, 56/09, 67/10 dhe 44/11), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit solli:

RREGULLORE PËR PËRMBAJTJEN MINIMALE TË EVIDENTIMIT DHE MËNYRËS SË PARAQITJES, PROVIGJONIMIT DHE LIKUIDIMIT TË DËMEVE NGA ANA E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet përmbajtja minimale e evidentimit dhe mënyra e paraqitjes, provigjonimit dhe likuidimit të kërkesave të dëmshpërblimeve (në tekstin në vijim: dëme) të shoqërive të cilat kryjnë veprimtari të sigurimit në grupin e sigurimit të jo jetës (në tekstin në vijim: shoqëri).

II. Evidentimi i dëmeve

Neni 2

(1) Shoqëria është e detyruar të mbajë evidencë të përgjithshme të dëmeve në Regjistrin e dëmeve.

(2) Përveç evidencës së përgjithshme të dëmeve në Regjistrin e dëmeve, shoqëria duhet të mbajë edhe evidencë individuale të dëmeve në vijim:

1. Evidencën e dëmeve në bazë të Kartonit jeshil,
2. Evidencën e dëmeve të shërbimit,
3. Evidencën e dëmeve të Fondit garantues,
4. Evidencën e dëmeve të regresit,
5. Evidencën e dëmeve me këste,
6. Evidencën e padive.

(3) Përveç evidencës së përgjithsme dhe individuale, shoqëria është e detyruar të përgatitë edhe Regjistrim të dëmeve si pjesë e evidencës së përgjithshme të dëmeve.

(4) Të dhënat në evidencën e përgjithshme dhe atë individuale dhe Regjistrimi i dëmeve krijohen nga sistemi informativ i shoqërisë.

Regjistri i dëmeve

Neni 3

(1) Regjistri i dëmeve është dokument për evidencë të rreptë.

(2) Regjistri i dëmeve menaxhohet si në vijim:

- qendror, në nivel të shoqërisë,
- për një vit kalendarik,
- në formë elektronike.

(3) Në regjistrin e dëmeve për vitin aktual kalendarik evidentohen vetëm ato dëme të cilat paraqiten për herë të parë në shoqëri, pavarësisht nga data e në të cilën ka ndodhur dëmi.

(4) Shoqëria e përmbyll Librin e dëmeve më 31.12 në vitin aktual kalendarik, me numrin rendor të dëmit të fundit të paraqitur atë ditë.

(5) Shoqëria përgatit përmbledhje të dëmeve, për çdo klasë të sigurimit veçmas, me gjendjen e datës 31.12. të vitit aktual ndërsa saktësia e përmbledhjes konfirmohet me nënshkrim të personit përgjegjës në sektorin Dëme dhe me vulë të shoqërisë.

(6) Regjistri i dëmeve sipas paragrafit 4 të këtij neni përmbyllet lidhur me evidentimin e dëmeve të reja të paraqitura në vitin aktual kalendarik, por i njëjti mbetet aktiv dhe i hapur deri në zgjidhjen e të gjitha dëmeve të evidentuara në të.

Evidenca e dëmeve në bazë të Kartonit jeshil (KJ/AP)

Neni 4

Evidenca e dëmeve në bazë të kartonit jeshil i përmban dëmet të cilat janë trajtuar dhe paguar nga ana e shoqërive të huaja për sigurim apo shtëpitë ndihmëse, në emër dhe për llogari të një shoqërie sigurimi të vendit.

Evidenca e dëmeve në shërbim të klinetit (KJ/DSH)

Neni 5

Evidenca e dëmeve në shërbim të klientit i përmban dëmet e trajtuara dhe të paguara nga ana e shoqërive të sigurimeve të vendit në emër dhe për llogari të një shoqërie të huaj për sigurim.

Evidenca e dëmeve nga Fondi garantues

Neni 6

Evidenca e dëmeve nga Fondi garantues përmban dëmet të cilët shoqëria i ka trajtuar dhe paguar në bazë të automjeteve motorike të pa siguruara dhe të panjohura dhe rasteve të tjera të parapara me ligj për të cilat shoqëria ka të drejtë rikthimi të kompensimit të dëmit të paguar nga Fondi garantues.

Evidentimi i padive

Neni 7

Evidentimi i padive përmban të gjitha proceset e ngritura gjyqësore kundër shoqërisë me të cilat paditësi kërkon kompensim të dëmit nëpërmjet gjykatës.

Evidentimi i dëmeve të regresit

Neni 8

Evidentimi i dëmeve të regresit përmban të gjitha kërkesat të cilat shoqëria i ka në bazë të të drejtës së kompensimit të shumës të cilën ia ka paguar të siguruarit, gjegjësisht përdoruesit të sigurimit, nga debitori i regresit.

Evidentimi i dëmeve me këste

Neni 9

Evidentimi i kësteve të sigurimeve të jo jetës paraqet dëmet me këste të evidentuara në Regjistrin e dëmeve, pas përcaktimit përfundimtar të kështit në procedurë gjyqësore apo jo gjyqësore.

Regjistrimi i dëmeve

Neni 10

(1) Regjistrimi i dëmeve përbëhet nga Regjistrimi i dëmeve të likuiduara por jo të paguara dhe Regjistrimi i dëmeve të provigjonuara në shoqëri, sipas klasave të sigurimit, sipas gjendjes së datës 31.12 në vitin aktual kalendarik.

(2) Regjistrimi i dëmeve nga viti paraprak i punës është pjesë përbërëse e Regjistrit të dëmeve për vitin aktual të punës.

(3) Regjistrimin e dëmeve e përgatit, kontrollon dhe konfirmon komisioni regjistrues i formuar nga shoqëria.

Mënyra e plotësimit të evidencës

Neni 11

Përmbajtja minimale e evidencës kryesore dhe individuale të dëmeve dhe Regjistrimi i dëmeve nga neni 2 të kësaj rregullore është përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregullore e cila është pjesë përbërëse e saj.

III. Paraqitja, provigjonimi dhe likuidimi i dëmeve

Neni 12

(1) Dëmi paraqitet me parashtrimin e një formulari të posaçëm të përcaktuar nga ana e shoqërisë apo kërkesë tjetër me shkrim (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesë për kompensim të dëmit).

(2) Elemente obliguese të Kërkesës për kompensim të dëmit janë:
- Emri dhe mbiemri/Emri i të dëmtuarit,
- NPIQ/NPT i të dëmtuarit,
- adresa e vendbanimit të të dëmtuarit,
- Data dhe vendi i paraqitjes së dëmit,
- Data kur ka ndodhur dëmi,
- Të dhëna për policën e sigurimit,
- Përshkrimi i ngjarjes së dëmshme,
- Nënshkrimi/nënshkrimi dhe vula e të siguruarit/personit të dëmtuar.

(3) Shoqëria e sigurimit është e detyruar që dëmin e paraqitur ta evidentojë në Regjistrin e dëmeve më brenda një afat prej 2 ditëve të punës nga dita e pranimit të Kërkesës për kompensim të dëmit.

(4) Në momentin e evidentimit të Kërkesës për kompensim të dëmit në Regjistrin e dëmeve, dëmi merr një numër unik të krijuar nga sistemi informativ i dëmeve.

(5) Shoqëria e sigurimit është e detyruar të formojë lëndë e cila do të menaxhohet me numrin i cili është i evidentuar në Regjistrin e dëmeve.

Neni 13

(1) Shoqëria është e detyruar, me rregullore të brendshme të përcaktojë Listë të dokumentacionit të nevojshëm për trajtimin dhe likuidimin e dëmit, dhe afate në të cilat shoqëria do të kërkojë dokumentacion shtesë të nevojshëm për zgjidhjen e dëmit.

(2) Secili dokument i pranuar duhet të përmbajë datën e pranimit.

(3) Dokumentacioni i lëndës dhe evidenca elektronike e dokumentacionit duhet të përmbajnë informata identike.

Neni 14

(1) Në momentin e evidentimit të dëmit në Regjistrin e dëmeve, shoqëria është e detyruar të ndajë një shumë fillestare të provigjonit për dëme sipas informatave fillestare për shumën e dëmit, gjegjësisht shumën mesatare të provigjonit nëse për momentin nuk mund të përcaktohet shuma e dëmit.

(2) Me secilin dokumentacion dëshmi të siguruar shtesë i cila tregon për ndryshim të shumës fillestare të provigjonuar për dëme, shoqëria është e detyruar të kryejë ndryshime në provigjonet për dëme në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të dokumentacionit shtesë.

(3) Shoqëria është e detyruar çdo ndryshim në shumën e provigjonit për dëme ta evidentojë në Librin e dëmeve dhe ta shënojë datën e ndryshimit dhe e njëjta të evidentohet në historinë e provigjonimeve.

Neni 15

(1) Pas zgjidhjes së dëmit, shoqëria është e detyruar të informojë me shkrim parashtruesin e kërkësës për dëmshpërblim për dëmin e zgjidhur, duke theksuar: shumën e kompensimit të dëmit, mundësinë dhe afatin e dorëzimit të ankesës deri te shoqëria në rast të pakënaqësisë së klientit dhe afatin për pagesën e dëmit i cili nuk guxon të jetë më i gjatë se 14 ditë nga dita e likuidimit të dëmit.

(2) Dorëzimi i ankesës nga ana e klientit nuk e anulon pagesën e pjesës së pakontestuar të dëmit.

IV. Dispozita kalimtare

Neni 16

Dispozitat nga nenet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të kësaj rregullore do të aplikohen nga data 01.04.2012, dhe do të vlejnë për të gjitha dëmet e paraqitura për herë të parë në shoqëri nga data 01.01.2012.

V. Dispozita përfundimtare

Neni 17

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

Nr.0201-4495/2
Shkup, më datë 28.12.2011

Kryetar i Këshillit të ekspertëve
d-r. Klime Popovski

SHTOJCA 1

PËRMBAJTJA MINIMALE E EVIDENTIMIT TË DËMEVE

1. REGJISTRI I DËMEVE

1. Numri i dëmit
2. Data e ndodhjes së dëmit
3. Data e paraqitjes së dëmit në shoqëri
4. I siguruari:
    - Lloji i të siguruarit (person fizik/juridik)
    - Emri dhe mbiemri/emri i personit juridik
    - Numri i policës
    - Kohëzgjatja e sigurimit (prej –deri)
    - Llloji i automjetit
    - Përcaktim gjeografik
5. Personi i dëmtuar:
    - Lloji i të siguruarit (person fizik/juridik)
    - Emri dhe mbiemri/Emri i personit juridik
6. Lloji i dëmit (M, DJM, DM)
7. Shuma e provigjonit të dëmit
8. Shuma e provigjonit për shpenzime të drejtpërdrejta për trajtimin e dëmeve
9. Shuma totale e provigjonuar
10. Data e dëmit material të likuiduar
11. Shuma e dëmit material të likuiduar
12. Data e dëmit jo material të likuiduar
13. Shuma e dëmit jo material të likuiduar
14. Shuma e likuiduar e shpenzimeve të drejtpërdrejta për trajtimin e dëmeve
15. Shuma totale e likuiduar
16. Data e pagesës së dëmit material
17. Shuma e pagesës së dëmit material
18. Data e pagesës së dëmit jo material
19. Shuma e pagesës së dëmit jo material
20. Shuma e paguar e shpenzimeve të drejtpërdrejta për trajtimin e dëmeve
21. Shuma e përgjithshme e paguar
22. Klasa e sigurimit
23. Tarifa/(shifra)
24. Shkaku i dëmit (shifra)
25. Data e arkivimit

2. PËRMBLEDHJE PËR DËME

1. Numri total i dëmeve të paraqitura;
2. Numri total i dëmeve të provigjonuara;
3. Shuma totale e dëmeve të provigjonuara;
4. Numri total i dëmeve të likuiduara;

5. Shuma totale e dëmeve të likuiduara;
6. Numri total i dëmeve të paguara;
7. Shuma totale e dëmeve të paguara;
8. Numri total i dëmeve të refuzuara;
9. Numri total i dëmeve të likuiduara, por jo të paguara;
10. Shuma totale e dëmeve të likuiduara, por jo të paguara.

3. EVIDENTIMI I DËMEVE NË BAZË TË KARTONT TË GJELBËR

1. Numri i dëmit
2. Data e ndodhjes së dëmit
3. Data e paraqitjes
4. Shkaktar i dëmit
5. Personi i dëmtuar
6. Numri i regjistrimit të automjetit (të dëmtuar dhe shkaktar)
7. Shuma e likuiduar në bazë të dëmit
8. Provizion për trajtimin e dëmit
9. Shuma totale e paguar në bazë të dëmit
10. Data e pagesës
11. Data e arkivimit

4. EVIDENTIMI I DËMEVE TË SHËRBIMIT

1. Numri i dëmit
2. Data e paraqitjes
3. Data e ndodhjes së dëmit
4. I dëmtuari
5. Shkaktar i dëmit (i siguruar i huaj)
6. Numri i regjistrimit të automjetit të të dëmtuarit dhe shkaktarit
7. Refundues
8. Shuma e likuiduar
9. Shuma e paguar
10. Shuma e refunduar
11. Provizion për trajtimin e dëmit
12. Data e shumës së refunduar
13. Data e arkivimit

5. EVIDENTIMI I DËMEVE NGA FONDI GARANTUES

1. Numri i dëmit
2. Data e paraqitjes
3. Data e ndodhjes së dëmit
4. Personi i dëmtuar
5. Shkaktari i dëmit
6. Lloji i automjetit
7. Numri i regjistrimit të automjetit
8. Shuma e likuiduar
9. Shuma e paguar
10. Data e pagesës
11. Shuma për refundim nga FG

12. Data e refundimit nga FG
13. Provizion
14. Data e arkivimit

6. EVIDENTIMI I PADIVE

1. Numri i dëmit
2. Numri i lëndës së paditur
3. Data e raportimit të dëmit në shoqëri
4. Të dhëna për të dëmtuarin:
   - Emri dhe mbiemri/emri i të dëmtuarit
   - Numri i policës
   - Kohëzgjatja e sigurimit (prej – deri)
5. I autorizuari
6. Data e padisë
7. Numri i lëndës në procedurë gjyqësore
8. Vlera e kërkesëpadisë
9. Borxhi kryesor
10. Interesi
11. Shpenzime gjyqësore të procesit
12. Data e arkivimit të dëmit

7. EVIDENTIMI I DËMEVE TË REGRESIT

1. Nurmi i dëmit
2. Numri i dëmit të regresit
3. Baza për regres
4. Data e hapjes së dëmit të regresit (data e pagesës së dëmit)
5. Shuma e kërkesës së regresit
6. Emri dhe mbiemri/Emri i debitorit të regresit
8. Mënyra e pagesës së kërkesës së regresit
9. Data e refundimit
10. Shuma e refunduar
11. Data e mbylljes së dëmit të regresit
12. Vërejtje
13. Data e arkivimit

8. EVIDENTIMI I DËMEVE ME KËSTE

1. Numri i dëmit
2. Data e regjistrimit të dëmit me këste
3. Përdoruesi i kështit:
   - Emri dhe mbiemri
   - Adresa
4. Provigjonimi i transferuar më 01.01 në vitin aktual
5. Shuma totale e qirave mujore të paguara në vitin aktual
6. Provigjonimi më 31.12. në vitin aktual
7. Data e arkivimit

9. REGJISTRIMI I DËMEVE TË PROVIGJONUARA

1. Numri i dëmit

2. Numri i policës
3. Data e paraqitjes së dëmit në shoqëri
4. Shuma e dëmit të provigjonuar material
5. Shuma e dëmit të provigjonuar jo material
6. Shuma e provigjonit për shpenzime të drejtpërdrejta për trajtimin e dëmeve
7. Shuma totale e provigjonit

10. REGJISTRIMI I DËMEVE TË LIKUIDUARA, POR JO TË PAGAURA

1. Numri i dëmit
2. Numri i policës
3. Data e likuidimit të dëmit në shoqëri
4. Shuma e dëmit material të likuiduar
5. Shuma e dëmit jo material të likuiduar
6. Shuma e shpenzimeve të drejtpërdrejta të likuiduara
7. Shuma totale e likuiduar